



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1322/16 Prot.

Durrës, më 6.10.2021

VENDIM
Nr 63, datë 6.10.2021

PËR

**"MIRATIMIN E ORËVE TË KURSEVE INTENSIVE TË UNIVERSITETI
"ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS"**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin Nr.29, datë 10.09.2018 për "Veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL-të " i ndryshuar me Udhëzimin Nr.36, datë 23.11.2018 dhe Udhëzimin Nr.37, datë 04.12.2018, të Statutit, të nenit 73 të Rregullores së Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Senati Akademik

VENDOSI:

1. Miratimin e orëve të kurseve të intensive si pjesë e ngarkesës mësimore brënda normës vjetore, në Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.
2. Lektori që ka realizuar kurset intensive, i pasqyron ato në formularin përmbledhës të ngarkesës mësimore të vitit akademik që i ka realizuar.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - ✓ Zv. Rektorët.
 - ✓ Administratori i Universitetit
 - ✓ Drejtuesit e Njesisë Kryesore.
 - ✓ Drejtuesit e Njesisë Bazë.
 - ✓ Drejtorja e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Prof. Dr. Kseanela **SOTIROFSKI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE STANDARDEVE TË CILËSISË

"RELACION MBI KURSET INTENSIVE"

Prof.As.Dr.Kseanela SOTIROFSKI,Rektor
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

Enderuar Znj. Rektore,

Bazuar në.

- Ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë";
- Udhëzimin Nr.29, datë 10.09.2018 për "Veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL-të" i ndryshuar;
- Udhëzimin Nr.36, datë 23.11.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin Nr.29, datë 10.09.2018 për "Veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL-të".
- Udhëzimin Nr.37, datë 04.12.2018 "Një ndryshim në Udhëzimin Nr.29, datë 10.09.2018 për "Veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL-të, i ndryshuar".

Personeli akademik ushtron veprimtarinë e tij sipas përcaktimeve të këtyre Udhëzimeve si edhe Statutit dhe Rregullores së UAMD-së. Më saktësisht, një nga veprimtaritë që kryen personeli akademik sipas Pikës 3 të Udhëzimin Nr.29, datë 10.09.2018 për "Veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL-të" i ndryshuar, është "Mësimdhënia", kjo e fundit sipas Pikës 4 të po të njëjtit udhëzim ku shprehet se, mësimdhënia si veprimtaritë në audior përfshin: Leksion, Seminare, Lëndë Speciale, Ushtrime, Laboratorë, Projekte Kursi, Detyrë Kursi, etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE STANDARDEVE TË CILËSISË

Në vazhden e këtij interpretimi, Sektori i Çështjeve Mësimore ka realizuar përlllogaritjet e ngarkesave mësimore të personelit akademik me kohë të plotë duke u bazuar në orët e realizuara nga ana e çdo lektori, brenda në auditor (si edhe jashtë tij).

Në tabelën e përlllogaritjeve të orëve mësimore janë përfshirë:

1. Totali i orëve të realizuara në ciklin e parë të studimeve bachelor,
2. Totali i orëve të realizuara në ciklin e dytë të studimeve master,
3. Totali i orëve të realizuara gjatë sezonit të verës dhe të vjeshtës.

Gjithashtu, si orë suplementare brenda në auditor janë përlllogaritur duke u bazuar në të gjitha orët e realizuara në zërat e lartpërmendura.

Orët suplementare jashtë auditorit përfshijnë orët e praktikave të realizuara në institucione të tjera si dhe orët e udhëheqjeve të temave të diplomës.

Në vitin akademik 2019–2020, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Fakulteti i Shkencave Politike Juridike ka realizuar kurse vere/vjeshte (intensive), bazuar në nenin 73 të Rregullores së UAMD-së, ku shprehet se:

“Kurse intensive janë seksione për ndjekjen me frekuentim intensiv 2-3 javor të lëndëve të caktuara. Hapja e kurseve intensive propozohet nga një grup prej 30 studentësh dhe miratohet me vendim dekanati. Në raste të veçanta për lëndët që nuk janë ofruar gjatë semestrave të rregullt ose kur studentët pengohen për t’u diplomuar për shkak të mbetjes vetëm në një kurs, me kërkesë të tyre dhe me vendim të Dekanatit mund të hapet kursi intensive përkatëse dhe me më pak se 30 studentësh, porasnjëherë me më pak se 15 studentë. Kurset intensive mund të ofrohen vetëm në sezonin e verës dhe në sezonin e vjeshtës. Ato realizohen duke u përmbajtur syllabuseve të lëndëve përkatëse dhe të gjitha rregullave që janë në fuqi për semestrat e rregullt mësimor”.

Përsa mësipër cituar, Sektori i Çështjeve Mësimore i ka përlllogaritur orët mësimore të “Kurseve Intensive” si orë të realizuara nga ana e lektorit si pjesë e ngarkesës mësimore brënda vitit akademik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE STANDARDEVE TË CILËSISË

Sezoni i verës dhe i vjeshtës realizohet bazuar në kërkesat e studentëve të cilët janë në faze diplomimi, këto orë janë përfshirë në ngarkesën mësimore vjetore duke qenë se realizohen brënda vitit akademik.

Përsa i përket vitit akademik 2020 – 2021 në realizimin e ngarkesës mësimore vjetore nuk ka patur orë të realizuara në sezonin e verës dhe të vjeshtës, përveç një lektori në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit i cili ka realizuar 45 orë mësimore, të cilat janë përfshirë në ngarkesën mësimore vjetore.

Për sa më sipër parashtruar, , i konsideron "Kurset Intensive", konsiderohen, të parashkikura në Regulloren e UAMD-së, pjesë e ngarkesës mësimore vjetore sipas pikës 3 dhe 4 të Udhëzimit Nr.29, datë 10.09.2018 për "Veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL-të indryshuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

ZV. REKTOR

PhD. Renata TOKRRI